



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF
SUHAREKA

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS			
REPUBLIKA KOSOVA - OBŠTINA SUHAREKA			
REPUBLIC OF KOSOVO - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRE NE DOREZIM - PRIMLJENJE			
Numri i Org. Unit	Numri i Braj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	0/6	1/91	2

Nr.	Komisioni Komunal për zhvillimin e procedurave dhe shqyrtimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtë dhe afatgjatë të pronës komunale	15.01.2019
-----	--	------------

Duke u bazuar në nenin 9 të ligjit nr.04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, neni 15 paragrafi 2 të rregullores QRK nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, komisioni në përberje prej Emrush Bytyçi kryesues, Sanie Kuqi, Besa Kuqi, Antigona Kolgeci, Xhemajl Kabashaj, dhe Driton Maliqaj anëtar, në qështjen juridike vlerësimin e ofertave në konkurimin e hapur Nr. 02/2018 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të parces në ZI Shirokë në mbledhjen e mbajtur me datën 14.01.2019 në seancën jo publike gjatë shqyrtimit komisioni me shumicën e votave vendosi që të nxjerr këtë vendim dhe atë duke u bazuar në nenin 44, lidhur me nenin 48, të Ligjit Nr-05/L-031, për Procedurën e përgjithshme Administrative:

VENDIM

- I. ANULOHET – konkurimi i hapur Nr.2/2018 i datës:19.11.2018 me Nr.protokoli 11-463-73602 për dhënie në shfrytëzim afatëgjatë të pronës së paluajtshme të komunës. Parcela kadastrale Nr.2785/25 me sipërfaqe prej 8000 m², sipas planit rregullativ “depo ndertimore” pasuri shoqërore në emër të ”Komuna e Suharekës”, pas që vlera e investimeve e dhënë nga ofertuesit që kanë konkuruar nuk është në raport dhe në harmoni me çmimet e tregut në Republikën e Kosovës, si dhe përshkrimi vendeve të punës dhe numri i punëtorëve në këtë hapsirë është jo i realizueshëm.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Komuna e Suharekës përkatësisht komisioni për zhvillimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatëgjatë dhe afatshkurtë të pronës së paluajtshme komunale ka bërë shpalljen e konkurimit të hapur Nr. 2/2018 të datës : 19.11.2018 me nr protokoli 11-463-73602 për dhënie në shfrytëzim afatëgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për parcelën kadastrale Nr.2785/25 me sipërfaqe prej 8000 m², sipas planit rregullativ “depo ndertimore” pasuri shoqërore në emër të ”Komuna e Suharekës”.

Në këtë konkurim kanë konkuruar gjithsej dy operatorë ekonomik:

“Graniti” sh.p.k me përfaqësues Bedri Lumi me seli në Suharekë, dhe “Seti Commerc” me përfaqësues Nysret Bajraktari me seli në Suharekë.

Komisioni i lartëcekur me datë 10.01.2019 ka bërë hapjen e ofertave ku prezent kanë qenë edhe ofertuesit e te dy ndërmarrjeve të lartcekura, ndërsa me datë 14.01.2019 komisioni ka filluar procesin e vlersimit të ofertave ku konstatoi se:

1. Vlera e investimeve e dhenë nga ofertuesit që kanë konkuruar nuk është në raport dhe në harmoni me çmimet e tregut në Republikën e Kosovës, dhe është kamufluuar me sasi të cilat nuk përputhen plotësisht me Projektin.
2. Përshkrimi i vendeve të punës është vetëm sa për të arsyetuar vendet e punës dhe numri i punëtorëve në këtë hapsirë është jo i realizueshëm brenda objektit. Nuk ka kushte të punës dhe hapësirë për veprim në objekt.
3. Gjatë shqyrtimit të dosjes janë hasur gabime artimetike në paramasë dhe parallogari.

Operatori ekonomik “Graniti” sh.p.k në vlerën investive kishte ofertuar vlerën 6,616,253.90, e që për komisionin kjo vlerë e investimeve nuk është në harmoni dhe në përputhshmëri me çmimet e tregut, dhe nuk është në harmoni dhe përputhshmëri me destinimin e ushtrimit të veprimtarisë në parcelën e lartëcekur.

Operatori ekonomik “Seti Commerc” në vlerën investive kishte ofertuar vlerën 3,092,025.50 e që për komisionin kjo vlerë investive nuk është në harmoni dhe në përputhshmëri me çmimet e tregut dhe nuk është në harmoni dhe përputhshmëri me destinimin e ushtrimit të veprimtarisë në parcelën e lartëcekur.

Nga ato që u thanë më lartë, komisioni në seancën e mbajtur me datë 14.01.2019 me shumicën e votave të anëtarëve të komisionit vendosi që këtë procedurë të konkurimit të hapur ta anulojë dhe për të njëjtën të fillon procesi I ri-konkurimit të hapur .

Këshillë juridike: kundër këtij vendimi pala e paknaqur ka të drejtë të bëjë ankesë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë dite) nga dita e pranimt të këtij vendimi në komisionin e ankesave të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

Kryesuesi i komisionit:



Emrush BYTYÇI

